



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 18.06.2024

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 **Nr. Br.** 400/01-11968/24
18.06.2024
Dragash - Dragaš

PROCESVERBAL

Dëgjimi buxhetor me OJQ, biznese dhe fermerë për
Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027

I mbajtur më 13.06.2024 (e enjte)

VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Dëgjimi buxhetor me OJQ, biznese dhe fermerë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën 28.05.2024.

Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/05/Kalendari-i-dëgjimeve-buxhetore-1.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/05/Kalendari-i-dëgjimeve-buxhetore-2.pdf>

Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/JN6ZVtKF8XbF3djL/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/2iU5-ACD7YRQs76rk/>

Njoftimi në uebfaqen zyrtare:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/06/Njoftimi-1-Scan-1.pdf>

Dëgjimi buxhetor ka filluar në ora 11:35 dhe ka përfunduar në ora 12:00.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **33 pjesëmarrës, prej tyre 26 meshkuj dhe 7 femra.**

Hapjen e takimit e ka bërë kryetari i Komunës, Bexhet Xheladini, i cili i ka falënderuar për pjesëmarrjen të gjithë të pranishmit. Ky debat që do të mbahet sot është debati i parë, do t'i kemi edhe dy debate tjera për buxhetin apo Kornizën Afatmesme Buxhetor 2025-2027. KAB-i është pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) dhe është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2025-2027. KAB-i është përpiluar duke u bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Kufijt Administrativ Komunal. Shqyrtimi i KAB-it duhet t'i kalojë disa faza. Në fillim të qershorit është drafti i KAB-it, neve drafti na ka ardhë, pastraj kah mesi i qershorit duhet të fillojmë me debatet publike me qytetarë, ndërsa në fund të këtij muaji Asambleja Komunale e miraton KAB-in. Buxheti përfundimtar miratohet në shtator. Buxheti i vitit 2024 ka qenq 12,110,967 euro, kurse buxheti i vitit të ardhshëm është 12,872,240 euro.

Kryetari Xheladini prezantoi në pika të shkurta planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm, duke u bazuar në strukturën organizative të Komunës. Zyra e Kryetarit do t'i ketë 110 mijë euro, bujqësia do t'i ketë 100 mijë euro, kultura 140 mijë euro, dhe arsimi për bursa do t'i ketë 50 mijë euro. Gjithsej subvencione këtë vit do t'i kemi 400 mijë euro. Investime kapitale do t'i kemi 4 milionë e gjysmë. Unë nuk do ta zgjas më shumë, nëse ka diçka me thënë drejtori i Buxhetit, pastaj fjala do të kalojë tek ju. Ju falemnderit!

Qamil Kolloni – drejtor pwr Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Ju përshtesës të gjithëve! Ajo çka është e mira e këtij buxheti, është se kemi një rritje për dallim nga viti i kaluar. Si Qeverisje lokale, ne jemi të interesuar ta rrisim mirëqenien e qytetarëve. Kemi kërkuar një shtim të numrit të punëtorëve në DKRS, për shkak të ndërtimit të dy stadioneve, që të kemi një numër shtesë të punëtorëve për mirëmbajtjen e tyre. Gjithashtu, numër shtesë të punëtorëve kemi kërkuar edhe për qendrat me bazë në komunitet. Pra, të gjitha këto punë të mira të cilat janë bërë vitet e kaluara, në vitin 2025 presim nga Qeveria që të marrim edhe miratimin për shtimin e këtyre punëtorëve. Gjithashtu, investimet kapitale kanë një rritje shumë të madhe, besojmë që deri në përfundim të vitit do të kemi edhe një shtim të investimeve tjera. Mendoj se të gjitha fshatrat dhe të gjitha institucionet do të jenë të përfaqësuara denjësisht. Andaj, pa humbur shumë kohë, dua të hap debatin që të bëni kërkesa ju, që të shohim se a kemi mundësi t'i inkorporojmë në buxhetin e vitit 2025.

Burim Piraj, qytetar (biznesmen): Ju përshëndes të gjithëve që jeni prezent këtu! Shpresoj se do të japim një kontribut të mirë për zhvillimin e Komunës sonë! Unë i dëgjova këto të dhënat që i dhatë ju për buxhetin dhe po më vjen mirë që për investime kapitale ka mjaft mjete. Por, m'u duken pak 100 mijë euro për bujqësi, unë mendoj se të mos subvencionohen pronat, por të subvencionohet produkti. Mendoj se kjo jep rezultat në krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e Komunës sonë, sepse i kemi dy sektorë që janë të rëndësishëm: bujqësinë (bletgorinë) dhe turizmin, dhe në këto dyja duhet të koncentrohemi sa më shumë që të mund të vjelim rezultate. Unë i kam disa kërkesa për Komunën. Mendoj se fshati ku unë jetoj nuk është mirë me rrugë me fshatrat fqinj, me Rapçën dhe me Buqen. Mendoj se duhet të bëhet lidhja me këto dy fshatra, sikur që është lidhur për shembull Baçka me Zlipotokun. Pastaj, aty ku jetoj unë, në 1 km gjatësi, prej fshatit Plavë deri te Viva Fresh-i, është një vend që ka dy pompa të benzinës, e ka një fabrikë, e ka një shitore të parketit dhe të produkteve të ndryshme, ka një supermarket që është Viva Fresh, ka autolarje, ka punëtori tjerë, dhe mendoj se kjo rrugë 1 km duhet nga Komuna jonë të konsiderohet si zonë me prioritet, se ka shumë të punësuar, edhe duhet të krijohet një infrastrukturë pak më ndryshe. Duhet të kjo zonë të bëhet me trotuare, nuk është ndonjë investim shumë i madh. Aty, në atë zonë ku po flas unë, i kemi pas dy aksidente fatale, ku një fëmijë dhe një i moshuar kanë pësuar. Prandaj, duhet pak të shtohen masat dhe të rritet siguria në atë pjesë. Gjithashtu, në atë pjesë mendoj se Komuna jonë duhet – në një diametër 500 m nga shtëpia e fundit, krejt atë zonë ta shpallë si zonë industriale, dhe të punohet në krijimin e një projekti për zhvillimin e asaj zone, se ka potencial zhvillimor ajo zonë, sepse aty është njëfarë qendre ku gravitojnë edhe Opoja, edhe Gora, edhe është interesante për investime. Prandaj, duhet të ketë infrastrukturë shumë të mirë, në mënyrë që kush do me bo investime aty, me e pas më lehtë. Kam edhe një propozim në lidhje me Pishat. Unë kam qenë para do kohe në Ferizaj, i kanë disa pisha sikur ne që i kemi atje, edhe e kanë ndërtue aty një park shumë fenomenal, ku gjatë pasditeve edhe vikendit krejt Ferizaji shkojnë aty, kalojnë kohën, i marrin fëmijët i çojnë aty. E di që ato pishat tona janë nën menaxhimin e AKP-së, mirëpo në bashkëpunim me AKP-në, qoftë edhe Komuna me e marrë me qira, përderisa të zgjidhet ai kontesti ligjor që Komuna ka me AKP-në. Me e marrë me qira edhe aty me bo staza, me bo shëtitore, me i krasit ato pishat sikur në Ferizaj që e kanë bo një bukuri të paparë. Unë edhe shkova për me e vizitue atë, mirëpo kish shumë keqpërdorime dhe ishin në shkatërrim e sipër. Ka shumë mbeturina, po ka edhe prerje, nuk e di kush i ka lejuë me pre. Por ky parkue, besoj që krejt Opojën edhe Gorën e kish pru në një pozitë krejt tjetër. Shëtitor, staza për ecje, pa i dëmtue pishat, s'ka nevojë me i dëmtue, sikur në Ferizaj që mundeni me shkue me e pa qysh e kanë bo sa bukur. Një parking të mirë aty, ku munden njerëzit me i parkue automjetet, edhe brenda është parku

fenomenal. Besoj se kjo është shumë një gjë e mirë, duhet t'i shfrytëzojmë se është pozita shumë e mirë për krejt fshatrat. Diçka më shumë nuk kam çka me thën. Ju falënderoj shumë!

Bexhet Xheladini: Faleminderit shumë! Unë do t'ju jap disa përgjigje. Sa i përket fshatit Plavë, lidhjes së këtyre rrugëve, ju bëjeni një kërkesë zyrtare prej fshatit, edhe ne do t'i bëjmë kërkesë KFOR-it Turk me e bo hapjen dhe trasimin e atyre rrugëve. Por me një kusht, që mos të ketë pengesa në prona, sepse nëse ka pengesa në prona ata nuk hyjnë. Vetëm të bëhet një procesverbal prej fshatarve se kah kalon traseja, me pika. Ne do ta vazhdojmë ndriçimin publik në atë pjesë, e kemi bërë kërkesën në KEDS për me e ngjit orën. Trotualet kemi pas me i bo vitin që shkoi, kemi dalë me e bo projektin, nuk kanë lënë njerëzit për shkak të pronave. Po megjithatë, e vetmja mundësi është me shti gypa njëmetërsh, mbi gypa me e bo trotuarin, se përndryshe nuk po lejojnë. Por me hek dorë nga trotualet nuk bën, duhet me i bo trotualet, se vërtet është një rrugë shumë e frekuentuar dhe e rrezikshme. Te Pishat: kjo është një ide shumë e mirë. Për fat të keq është pronë e Pylltarisë. Ne jemi duke e bërë stazën e ecjeve të Liqeni i Breznes, sot na i ka ndërprerë punët Pylltaria, po duhet me intervenue në qendër për me lejue stazën për ecje, nuk po lënë me e bo. Po megjithatë, ne duhet të bëjmë përpjekje. Sa i përket zonës industriale te Plava, ne do ta hapim tenderin për hartimin e PZhK-së, do të ketë debat me qytetarë, do t'ia japim një kompanisë së specializuar që ta hartojë. Ju do të vini aty, do t'i jepni propozimet dhe sigurisht atë zonë ne do ta bëjmë si zonë industriale, në mënyrë që të mos keni ju pengesa me e shndërrue tokën bujqësore në tokë industriale, me bo shpenzim edhe me pas neglizhencë dhe vonesa. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Ju kisha lut ju që jeni të OJQ-ve këtu! A ka dikush që ka ndonjë OJQ, se sot ky takim më së shumt është i thirrur për biznese, OJQ dhe fermerë. Ju kërkuat që në bujqësi të rriten subvencionet, ne kemi pas 80 mijë vitin e kaluar, i kemi rrit për 20 mijë. Mirëpo, ju e dini që njerëzit që merren me bujqësi dhe blegtori marrin subvencione të dyfishta. I subvencionon edhe Qeveria, dhe për fat të mirë, vitin e kaluar dhe këtë vit, fermerët tanë janë në gjendje jashtëzakonisht të mirë. Kanë fitime, nuk kanë ankesa, për herë të parë ata janë të lumtur që po merren me këtë biznes. Subvencionet bëhen vetëm me të hyra vetanake. Ne të hyra vetanake i kemi 500 mijë euro, prej tyre 400 mijë i kemi ndarë për subvencione. Ne i subvencionojmë lopët, delet, dhitë, bletët, me qa mjete sa kemi, megjithatë, është një ndihmesë solide për ta. Sivjet planifikojmë të subvencionojmë edhe ata të cilët merren me mjedra, e me drithëra. Të shohim, nëse na mbesin mjete, me ua pague edhe karburantin. Në kuadër të këtyre mjeteve e planifikojmë edhe Panairin, aty kemi parapa të ndahen më shumë mjete sesa vitin e kaluar. Nëse nuk do dikush ta marrë fjalën, atëherë mundemi ta përfundojmë këtë takim. Faleminderit shumë për pjesëmarrjen!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/komuna-e-dragashit-filloi-degjimet-buxhetore-me-qytetare-per-kah-2025-2027/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/budzetska-saslusanja-sa-gradjanima-za-srednjorocni-budzetski-okvir-mbf-2025-2027-pocela-su-danas/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/LhDx9VQt4e8YjPUm/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/TCaSVTeXGY6PZoW7/>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*

02 Nr. Br. 400/01-11968/24
 13.06.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
 KOMUNA E DRAGASHIT
 DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 13.06.2024

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR
 ME OJQ, BIZNESE DHE FERMERË PËR
 KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2025 – 2027

LISTA UÇESNIKA NA RASPRAVA BUDŽETA SA NVO,
 PREDUZECIMA I POLJOPRIVREDNICIMA ZA
 SREDNJOROCNI BUDŽETSKI OKVIR 2025 - 2027

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Etnia	M	F	Nënshkrimi
Br.	Ime i Prezime	Prebivalište	Etnička pripadnost	M	Ž	Potpis
1	Elsa Krasnigi	DRAGASH	SHQIPTARE		F	
2	BETON QENGAJ	DENGASH	SHQIPTAR	M		
3	Semirza Misini	Dragash	shqiptare		F	
4	Armenli Armenli	Brace	shqiptar	M		
5	Ismael Berishaj	Kuka	shqiptar	M		
6	Miran Nebri	Blac	shqiptar	M		
7	Mimosa Berisha	BUÇE	shqiptare		F	
8	NIMETE BERISHA	BUÇE	SHQIPTARE		F	
9	Kallina Krasnigi	Brace	shqiptare		F	
10	FARI KOLLONJ	Kosovë	shqiptar	V		
11	BURIM PIRAS	PLAV	shqiptar	V		
12	Gazmend Ramadan	BRUT	SHQIPTAR	V		
13	MENDRES GJENJ	KUK	SH	X		
14	Ramadan Ahmeti	SHAJNE	SHQIPTAR	X		
15	Arbër Misini	DRAGASH	SH	V		
16	Veton Halili	Zapluxhe	Shqiptar	V		
17	Behar Zekri	Kosovë	SHQIPTAR	X		
18	Emolrit Piraj	PLAV	shqiptar	V		
19	Faton Nopaj	KUK	shqiptar	M		
20	Lindona Misina	Plave	shqiptare	F	F	
21	Adam Guri	Zgjeri	shqiptar	M		
22	Agon Barilali	Bellobrad	shqiptar	M		
23	SHAD TOSUNI	RATEA	BOSNIJAK	M		
24	Shaban Skender	BRUT	SHQIPTAR	M		

25	Bilall Lyman	QSCB	Shipton	X		Lyman
26	BENSI Misini		SHIPTAR	X		BENSI
27	FLORIAN IMENI	AS. ARIC	Shipton	X		IMENI
28	LINDITA MIRAT	ESBT	Shipton		X	Lyman
29	Dren Myrtzani	Epiluxhe	Shipton	X		Dren
30	FETOR FINEVIT	GRODICA	GOLANAC	X		FETOR
31	Endre Xigavce	Prod	Goranae	P		Endre
32	IBRAHIM KRYEZH	DEKOS	Shipton	X		IBRAHIM
33	RESUL FETAHU	KUK	Shipton	X		RESUL
34						
35						
36						
37						
38						
39						
40						
41						
42						
43						
44						
45						
46						
47						
48						
49						
50						
51						
52						
53						
54						
55						
56						
57						
58						
59						
60						
61						
62						
63						
64						
65						
66						
67						
68						
69						
70						

